

UDK: 343.85:343.352(497.115)

Review article

KORRUPSIONI SI FENOMEN SHOQËROR

MSc Nysret Hoxha*

Përmbledhje

Që nga pas lufta Kosova ka pësuar ndryshime radikale në të gjitha dimensionet e organizimit të jetës publike dhe private, konform progresit që është evident janë paraqitur edhe dukuri devijante të cilat janë shkake për zbehjen e imazhit të Kosovës brenda dhe jashtë. Një prej fenomeneve që mund të konsiderohet edhe sindrom social është paraqitja e Korrupsionit. Me këtë punim modest pretendoj të analizoj korrupsionin si fenomen si dhe konotacionet e tij në zhvillimet brendshme dhe në proceset diplomatike të Kosovës.

Fjalët kyçe: Korrupsioni, inkriminimi normativ, luftimi i korrupsionit.

1. Definimi i korrupsionit dhe etimologjia

Shprehja korrupsion ka prejardhje nga gjuha latine *Rumpere*- ndërprerje, thyerje, shkatërrim që decidivisht nënkupton ndërprerjen e një fenomeni. Si e tillë shprehja është e vështirë të zbërthehet dhe nga shprehja të kuptohet esenca e aktivitetit kriminal të quajtur korrupsion. Për tu realizuar korrupsioni gjithmonë duhen dy subjekte Cum *Rumpere*, diçka të bëhet apo të shuhet korruptuesi dhe i korruptuari.

Shprehja *rumpere* nuk plotëson mjaftueshëm dukurin e korrupsionit por korrupsioni si akt ka zgjuar vëmendjen e juristëve dhe sociologëve që të gjithë këtë dukuri e kanë trajtuar nga këndet e ndryshme. Sociologjikisht korrupsioni trajtohet si proces me të cilin injorohen përgjegjësit ndaj rendit publik duke u shfrytëzuar autorizimet e dhëna nga shoqëria, (Derancevic-faqe 36-37). Derancevic konsideron se një veprim të konsiderohet si korruptiv ai duhet të konsiderohet i tillë edhe nga opinioni publik.

Nëse i referohemi Konventës Interamerikane Kundër Korrupsionit hasim në disa definicione që të gjitha e trajtojnë korrupsionin nga kënde të caktuar duke e plotësuar kuptimin real të korrupsionit si:

* Ministria e Punëve të Brendshme Kosovës, e-mail: nysret.hoxha64@gmail.com.

Me korrupsion kuptohet ofrimi apo joshja direkte apo indirekte personit publik apo personit që bart autorizime publike, çfarëdo vlere të parasë apo përfitim tjetër, në këmbim me kryerjen e ndonjë akti apo lëshimi gjatë zbatimit të detyrës zyrtare.

Definicioni më i pranueshëm për momentin është nga banka botërore që shprehimisht thotë: korrupsioni paraqet keqpërdorim të autorizimeve publike me qëllim të përfitimit privat (personal). Ky definicion bënë të qartë se korrupsioni si kategori ndërlidhet me dy elemente kyçe me sektorin publik dhe personin zyrtar.

2. Historia e korrupsionit

Shikuar nga aspekti i së kaluarës korrupsioni si dukuri na paraqitet po thuaj në të gjitha epokat por në forma të ndryshme, varësisht nga niveli i civilizimit njerëzor. Duke filluar nga koha e Perandorisë Romake ku shteti i atëhershëm kishte paraparë norma rregulative përmes të cilave magistratët një vit pra se të përfundonin detyrën, ishin të detyruar për llogari dhënie. Problemet me fenomenin e korrupsionit kanë shënuar rritje kur shteti romak ka filluar ekspansion shtrirje nga të gjitha anët. Me qëllim të eliminimit të kësaj dukurie është formësuar proceduar e quajtur Qvestinios (hetimi gjyqësor). Hetimi gjyqësor që në atë kohë ka ndikuar në procesin zgjedhor të magistraturës.

Nëse i referohemi periudhës së feudalizmit për kundër faktit se feudalizmi njihet si periudhë stagnacioni dokumentet historike tregojnë se keqpërdorimi i pozitës ka qenë normativisht i rregulluar me ligjin e Soliumit që i referohet keqpërdorimeve nga ana e Grofëve. Në këtë periudhë kanë ekzistuar edhe norma tjera si Ligji i Burgunskit i Ripuarit. Në feudalizëm shihen tendenca për kthimin e vlerave të Drejtës Romake. Epoka feudaliste është e njohur për insolvencën e shtetit që ti kundërvihet të gjitha formave të keqpërdorimit të pozitave nga ana e mbajtësve të pushtetit.

Kapitalizmi i njohur si fill i vlerave ku pranohen idetë e Revolucionit Borgjez Francez, në shumë vende evropiane dukuria e korrupsionit si akt kriminal zë vend në kodet e reja penale të asaj kohe. Franca si djep i kulturës dhe pishtar i demokracisë korrupsionin e nominon në kod penal si *Krim i zyrtarëve gjatë kryerjes së funksioneve publike*. Nëse i referohemi shtetit Gjerman si vend me rëndësi të veçantë në Evropë kodi penal i Gjermanisë ka paraparë sanksionimin normativ të korrupsionit si dukuri, pasi që korrupsioni ishte mjaftë i theksuar në shtetin e atëhershëm gjerman, për këtë gjendje tregojnë shifrat për kohën prej vitit 1882 deri në vitin 1915, numri i personave të gjykuar për korrupsion është sjellë rreth 1400 persona për çdo vit.

3. Format e paraqitjes së korrupsionit

Korrupsioni si fenomen paraqitet në disa forma:

Forma individuale, forma e korrupsionit sistematik, format tjera të korrupsionit.

3.1. Forma individuale

Forma më e shpeshtë e paraqitjes së korrupsionit është forma individuale dhe njëherit më e thjeshta, e cila ka të bëjë me subjekte që nuk kanë funksione vitale, por janë zyrtar të niveleve të ulëta, kjo formë është e pranishme në të gjitha aktivitetet jetësore si: tregti, doganë, punë të brendshme (polici), e sidomos në shëndetësi. Forma individuale paraqitet si mitosje klasike që ka të bëjë me pozicionin e korrupsionit aktiv (dhënësit të mitos), ndërsa funksioni i zyrtarit, të mitosuri, është pasiv dhe ai duhet vetë të pajtohet me iniciativën e korrupsionit, në këtë mënyrë të pranoj marrëveshjen për vendimmarrje konform marrjes së mitos.

Sa i përket gjendjes aktuale edhe në Kosovë forma individuale të korrupsionit është më e përhapura.

3.2. Forma sistematike e korrupsionit

Sistemet e veçanta që nuk zgjedhin mjete as mënyra që të funksionojnë në mënyrë autonome ku si rast që i përgjigjet kësaj forme të korrupsionit mund të merret rasti Watergate në Amerikë.

Kësaj forme nëse i bëhet një analizë e mirëfilltë, duke ju referuar aspekteve psikologjike sociale e të tjera ky lloj i korrupsionit mund të paraqitet edhe në formë edukacionale si;

Korrupsioni = diskrecionin + monopolin /përgjegjësinë

$$K = d + m:p$$

Një prej segmenteve më të rëndësishme në këtë ekuacion është elementi i quajtur monopol -m, që nënkupton mungesën e konkurrencës, problem qenësor në Kosovë janë monopolizimet politike që de fakto janë formë e organizuar e koncentrimin të autorizimeve nën autoritetin e disa subjekteve, shpesh ndodh që një individ të ketë autorizime të pa kufijshme dhe diskrecion në marrjen e vendimeve me q' rast i mundësohet (i jepet rasti) për marrje të mitos.

Nëse i referohemi ekuacionit të sipërshënuar kemi edhe elementin e përgjegjësisë-p, që mund të konsiderohet si faktor inhibues në aktivitete e zyrtarëve të predispozuar ndaj korrupsionit. Përgjegjësia duhet të jetë mekanizëm relevant në nxjerrjen e vendimeve për të cilat zyrtari posedon edhe diskrecion (zgjidhje të lirë).

Diskrecioni-d, nxjerrje e lirshme e vendimeve që mundësisht të jenë sa më kualitative, koncepti i diskrecionit të lirë në procese vendimmarrëse sidomos në politikë, duhet të obligoj autoritetet që të veprojnë racionalisht apo si Homo economics. Në të shumtën e rasteve vendimmarrje e arsyeshme dhe kualitative e

subjekteve në pozita të larta e kombinojnë apo e konsiderojnë çështje të vullnetit apo dëshirës së tyre të lirë, që ndryshe do të definohej si *libertum arbitrum*. Që thjesht kjo i bie e bëjë atë që dua unë, atë veprim që mendoj se është i duhuri.

3.3. Format tjera të korrupsionit

Siç u shënuar më lartë ekziston korrupsioni aktiv dhe pasiv, ku me korrupsion aktiv identifikohet dhënësi i ryshfetit apo mitos, pra ai merr iniciativë për ta korruptuar zyrtarin që trajtohet si i korruptuari pasiv, apo pranues i mitos, në literaturë haset edhe korrupsioni institucional. E veçantë e formës institucionale të korruptimit është krijimi dhe formësimi i rregullave apo normave të vendimmarrjes në atë mënyrë që institucionet të krijoj të hyra të pa justifikueshme me qëllim të përfitimit. Kjo formë (korrupsioni institucional), dallohet nga të tjerat, sepse është i parashikueshme dhe i rregullt-subjekti e ka të njohur se duhet të kryej pagesa, ta zëmë për tu futur në hapësirën e spitalit.

Si formë tjetër dhe mjaft e përhapur është edhe korrupsioni i ashtuquajtur rrugor, apo më mirë do të ishte ta nominojmë si korrupsion ad-hoc i atëçastshëm.

Korrupsioni ad-hoc përfshin të gjitha format e blerjes së zyrtarëve publik ose personave përgjegjës pa planifikim paraprak (pa paralajmërim të subjektit aktiv për marrjen e mitos). Mitosja e tillë, ka për qëllim shmangien e personit zyrtar të mitosur nga obligimet e rregullta duke e vënë në pozitë të mitosur që të mos i përfillë normat për zbatimin e të cilave është i autorizuar. Kjo dukuri është e pranishme në rastet e aplikimit të gjobave të ndryshme, mitosja për të përfituar dobinë që nuk na takon, hyrja pa rend etj- kjo formë kryesisht është e pranishme tek zyrtarët policor, inspektorët tatimor, doganierët, ku kryesisht janë të pajisur me autorizime për sanksionim pa procedurë gjyqësore.

4. Gjykimi moral i korrupsionit

Nëse i referohemi qasjes morale në trajtimin e dukurisë së korrupsionit atëherë mund ta trajtojmë si dukuri patologjike (patologji në vete), ndërsa sociologjikisht korrupsioni paraqet anomali morale të shpërdorimit të funksionit publik (Dernčovič, 2000).

Morali realisht duhet të jetë mekanizëm që ndërton vetëdije për të dalluar veprimin e mirë nga e keqja, mund të konsiderohet korrektor i sjelljeve njerëzore.

Të moralshëm mund të konsiderohen vetëm ata që mund t'i rezistojnë testeve, sprovave joshëse që mund të paraqiten gjatë jetës e posaçërisht kryerjes së detyrës zyrtare pasi që detyra zyrtare na jep rastin për tu sprovuar.

5. Trajtimi i korrupsionit nga aspekti legal

Me qëllim të preventivës dhe eliminimit të korrupsionit shoqëria njerëzore ka parashikuar norma që në vete bartin edhe sanksione për të gjithë subjektet që merren me aktivitete korruptive.

Normimi i korrupsionit si problem daton nga kohërat e lashta, ku janë gjetur forma sanksionuese në kodin e Hamurabit, në ligjin e dymbëdhjetë tabelave. Në mënyrë të posaçme, kjo dukuri trajtohet edhe në shariat Islam, ku lë përshtypje qasja ndaj të korruptuarit aktiv apo mitëdhënësit, ku decidivisht sqarohet se: Të dy palët janë përgjegjës, por nëse dhënësi i mitos për të realizuar të drejtën që i takon, ka qenë i detyruar të jap ryshfet, ajo do t'i merret si rrethanë lehtësuese. (Nun, 2006)

6. Kosova dhe korrupsioni

Kosova, si shtet në tranzicion, karakterizohet me strukturë të demokracisë së brishtë, e cila vuan nga llogaridhënia e dobët. Një prej problemeve më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova, është problemi i korrupsionit. Fenomeni i korrupsionit është studiuar nga shumë organizata jo qeveritare brenda dhe jashtë Kosovës. Studiues të ndryshëm ndërkombëtar janë marrë me analiza të korrupsionit në Kosovë. Indeksi i vitit 2011, i Transparency International, lidhur me perceptimin e korrupsionit i jep notën 2.9 (që nënkupton korrupsion i lartë -pozita e 112 në mesin e 182 shteteve të përfshira në studim).

Në Kosovë që nga pas lufta ka ndryshuar edhe sjellja e njerëzve, tani kanë ndryshuar dhe qasja interpersonale dhe intrapersonale, gjithashtu edhe raportet ndaj shtetit dhe sjellja me qytetar ka ndryshuar, duke zëvendësuar qëndrimin e rreptë zyrtar me qëndrim nepotist dhe tolerant. Kjo mund të jetë edhe shkëndija e parë e mundësimit të mitosjes, ku njerëzit të mësuar të presin në radhë për të kryer një shërbim, tani mund të futeshin lirshëm në objektet shtetërorë, për shkak të një sjellje miqësore të administratorëve. Fillimisht qytetarët në shenjë mirënjohje i kanë ofruar dhurata zyrtarëve në të gjitha nivelet, pastaj ajo dukuri fillon të bëhet sindrom që zyrtari po sa të përfundoj punën të mendoj në dhuratë apo siç thuhet e çka unë?. Me qëllim të ndalimit dhe përafrimit të legjislacionit të Kosovës me ligjet e aplikueshme të vendeve tjera, korrupsioni dhe veprat korruptive janë të inkuorporuar në Kodin Penal të Kosovës.

Diskutimet rreth korrupsionit viteve të fundit po zënë vend të rëndësishëm si në institucionet kompetente ashtu edhe në masat e përgjithshme. Pas papunësisë dhe varfërisë, korrupsioni konsiderohet si sfida më e rëndësishme për Kosovën dhe ardhmërinë e sajë. Fushat më të prekura nga korrupsioni konsiderohen: prokurimet publike (tenderët), shëndetësia, doganat, posaçërisht sistemi i drejtësisë që është e autorizuar për luftimin dhe gjykimin e korrupsionit. Në indeksin e perceptimit të korrupsionit për vitin 2016, që botohet çdo vit nga Transparency International, Kosova klasifikohet si vendi i 36, ku parimisht vendi më i korruptuar shënohet si 0 (zero), kurse i pa korruptuar shënohet me 100. Ky klasifikim Kosovën e vë në një

pozitë të përafërt me vendet fqinje si Maqedonia 37 pikë , Mali i zi 45, Serbia 42, Shqipëria 39 pikë. Banka Botërore, lidhur me korrupsioni dhe lëvizjen vjetore të korrupsionit bën paraqitje tabelare, nga e cila kuptohet se për një periudhë nga viti 2006 deri në vitin 2011, korrupsioni në Kosovë sillet në të njëjtën pozitë.

Tabela nr. 1. Pasqyrimi i gjendjes së korrupsionit në Kosovë

vijet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
nivel	38.5	25.2	32.5	31.1	31.1	30.8

Nga UNDP është vrojtuar pulsi publik që në raportin e prillit të vitit 2016, është gjetur se 42% e qytetarëve të Kosovës, e konsiderojnë gjyqësorin si organin më të korruptuar.

Ndërsa sa i përket prokurorisë ekziston rreziku që prokurorët të ngrisin padi në formë fushate sa për ti bërë me dije opinionit se mbajnë një qëndrim të fortë dhe kanë qasje serioze ndaj dukurisë së korrupsionit.

Bazë për parandalim dhe sanksionim të veprave korruptive është Kodi Penal i Kosovës, i miratuar me: 06. korrik 2003, dhe kodi i ri-strukturuar në kod të ri penal i cili ka hyrë në fuqi më vitin 2013. Si kodi penal i vjetër edhe i riu kanë përputhshmëri të dispozitave që ndërlidhen me aktivitete korruptive,

Në pika të shkurta do të paraqitet trajtimi që i bënë kodi penal veprave korruptive si:

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar me kodin e vjetër është sanksionua me nenin 339 kurse me kodin e ri në neni 422. Në të dy kodet parashikohet:

Fillimisht i referohet personit zyrtar i cili duke shfrytëzuar detyrën zyrtare apo autoritetin zyrtar tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush obligimet me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo për tjetrin...që sanksionohet me vuajtje dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet. Shpërdorimi i detyrës në vete ngërthen: pranimin e dhuratave, dhënien e përparësisë përveç nëse lejohet me ligj.

Sanksionimi i ryshfetit aktiv -dhënia e ryshfetit neni 429:

Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë premton ose ofron ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar në mënyrë që ai të mos veproj në pajtim me detyrën e tij apo të veproj në kundërshtim me ligjin dënohet me gjobë ose me burgim deri në (3) vjet.

Marrja e ryshfetit në kodin e vjetër penal është sanksionuar me nenin 342, kurse me kodin e ri neni 428. Që tekstualisht thuhet:

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kërkon apo pranon ndonjë dhuratë apo përfitim për vete ose për personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë me kushte që personi të veproj apo të mos veproj konfirm detyrës së ti dënohet me burgim prej 6. muaj deri në 5 Vjet.

Vlen të shënohet se marrja apo dhënia e ryshfetit pra cilado formë e realizimit të korrupsionit nuk ndërlidhet me shkeljen e ligjit nga na e zyrtarit, edhe nëse vepron

me ligj në rastin e marrjes së ryshfetit duhet të sanksionohet. Kurse shkelja ligjore është sanksion tjetër ku për shkelje do të duhet të zbatohet sanksion i posaçëm.

Nëse i referohemi kodit të ri penal si i tillë në vete ngërthen një mori nene me të cilat do të sanksiononte veprimet abuzive të pushtetarëve dhe korrupsionin në çfarëdo niveli. Fusha e normimit të korrupsionit me dispozita ligjore përfshinë një gamë të gjerë dispozitash duke filluar nga neni 315, pranimi i pa arsyeshem i dhuratave deri te neni 437, raportimi i rremë ose mos raportimi i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë së çfarëdoshme financiar si dhe detyrimeve financiare.

Konform standardit ligjor që në një vend demokratik do të ishte i mjaftueshëm për rrethanat kosovare, mendoj se infrastruktura ligjore e tanishme do të duhej të plotësohet edhe me disa nene ku do të përfshihej sanksionimi për personat e tretë në rastin e korrupsionit pasiv apo marrësit të ryshfetit, pasi që kemi raste kur ryshfeti nuk i jepet direkt zyrtarit por një anëtar i familjes e posaçërisht bashkëshortit martesor. Pastaj të parashihet normative e veçantë për ndërmjetësit, që realisht në Kosovë janë të shpeshtë ata që ndërmjetësojnë në dhënien e ryshfetit, të gjendet formë apo të caktohet dispozitë e posaçme sanksionuese.

Sipas mendimit tim Kosova është e hendikepuar për të zgjidhur problemin e korrupsionit, përveç që nuk ka përvojë të mjaftueshme në lëmin e luftimit të kësaj dukurie, ajo ballafaqohet edhe me problemin qenësor se organet që janë të thirrura ta luftojnë dukurinë, janë institucionet më të korruptuara. Në këtë rast, theksi vendoset në organet e drejtësisë, e sidomos në sistemin gjyqësor. Në projektin kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (Jennet, 2017), parashtron autorizimet dhe përgjegjësitë e gjyqësorit, duke e renditur gjyqësorin në krye të institucioneve të korruptuara.

Komisioni i Venecias vë në dukje se pavarësia e gjyqësorit nuk është privilegj që i veçon gjyqtarët nga kontrolli publik dhe të qenit i përgjegjshëm për veprimet e veta.

Në gjykatat kosovare, gjyqtarët diskrecionin e konsiderojnë si diçka që u mundëson gjyqtarëve të veprojnë në mënyrë të lirshme dhe profitabile.

Mendimi përfundimtar dhe rekomandimet

Mendoj se Kosova si shtet në tranzicion është në formësim të një strukture të qëndrueshme legjislative, megjithatë çdo vonesë, ka koston të cilën do ta vuajnë shtetasit e Kosovës.

Luftimi i korrupsionit dhe dukurive të saj është kusht i Bashkësisë Ndërkombëtare që Kosova të ketë lëvizje të lirë (liberalizim të vizave).

Siç shënuam edhe më lart baza juridike duhet të plotësohet me norma sanksionuese por është relevante që të punohet në edukimin dhe ngritje e vetëdijes së qytetarëve se korrupsioni është vrasës i shtetësisë. Gjatë studimit të këtij fenomeni më ka impresionuar analiza e bërë nga filozofi Montesqye për çështjen e perandorisë Romake, ku si shkaktar kryesor të rënies së Perandorisë Romake evidenton përhapjen e korrupsionit, i cili jo vetëm që ka shkatërruar shtetin por edhe

ka qenë faktori kryesor i humbjes së superioritetit (epërsisë) morale të romakëve në raport me të tjerët. Përkitazi me këtë situatë mendoj se institucionet relevante të Kosovës konform plotësimeve të legjislacionit duhet të marrin masa edhe në edukimin e brezave duke futur lëndë mësimore si: etikë apo religjion, nëpër shkolla dhe universitete me qëllim të edukimit të masave. Kodit i etikës që është kusht për nominimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të mos jetë vetëm filtër për selektim që të pranohen personat që na duhen, por të jetë realisht në funksion të së mirës së përgjithshme.

Literatura

Drancevic, Mit(o) korupcija – Zagreb/ 2000.

Etchogoyen, podmicivac i pomiceni-Split/1977.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës-Prishtinë / 2003

Kodi Penal i Kosovës Prishtinë /2012

James Hamilton Vlersimi i rreziqeve të korrupsionit në sis. Prokurorial të Kosovës /2017

Victoria Jannett Vlersimi i rreziqeve të korrupsionit në sistemin Gjyqësor të Kosovës /2017.

CORRUPTION AS A SOCIAL PHENOMENA

Abstract

After war, Kosovo has made many changes in all dimensions of life in organizing the private and public life according to the progress that has been made, in Kosovo there are some occurrences that are fading the image of it. One of the occurrences that can be called as social syndrome is, corruption.

With this modest work, author pretending to analyze the corruption in Kosovo that it is affecting in negative way in Interior and in Diplomatic Processes of Kosovo.

Key words: Corruption, normatic incrimination, fighting corruption.

Article history:

Received: 15. 5. 2017.

Accepted: 12. 7. 2017.